



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 16, datë 10 / 03 /2022

PËR  
DHËNIEN E TITULLIT “*DOKTOR HONORIS CAUSA*” Z. BIRÇE HASKO

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, 38, VKM Nr.112, datë 23/02/2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, Kreu i V-të (Dispozita të fundit dhe kalimtare) pika 1, Statutin të UART (Funksionet e Senatit Akademik të UART) neni 24, gërma ff, si dhe në propozimin e Fakultetit të Artit Skenik, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

VENDOSI

1. Të japë titullin “Doktor Honoris Causa” për zotin Birçe Hasko me motivacionin:  
“Pedagog dhe aktor i shquar i teatrit dhe filmit shqiptar, me kontribut të madh e të jashtëzakonshëm në shkollën e artit skenik, interpretim të shkëlqyer të shumë figurave që ka realizuar e skalitur në teatër e kinematografi duke u bërë një nga aktorët më të dashur, si dhe shembull për të rinjtë që kanë zgjedhur të jenë e nesërmja e artit skenik e kinematografik shqiptar”.
2. Të caktojë reçentë Prof. Petrit Malaj dhe Prof. asoc. Alert Çeloaliaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

U.N. 279 Prot  
28/02/2022/11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANI

Nr. 53 prot.

Tiranë, më 24/02/2022

**Lënda:** *Propozim mbi dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" personalitetit shkollës së artit skenik, teatrit dhe kinematografisë Prof. Birçe Hasko*

**Drejtuar:** **Senatit Akademik të UART**

I nderuar Kryetar i Senatit Akademik të UART Prof. Kastriot ÇAUSHI

Të nderuar anëtarë të Senatit Akademik të UART,

Universiteti i Arteve ka krijuar ndër vite një fizionomi të qartë e të spikatur, jo vetëm në artin dhe kulturën shqiptare, por edhe në të gjithë spektrin social kulturor të vendit tonë. Duke vlerësuar se ky vend i nderuar që zë shkolla jonë e artit është arritur në saje të punës me përkushtim e sakrificë të mjaft personaliteteve të shquara, unë personalisht mendoj dhe besoj se duhet përherë të mbështesim dhe promovojmë pikërisht njerëzit që kanë dhënë kontribute të vazhdueshme për shkollën, kulturën e artin tonë.

Në këtë këndvështrim, si dhe bazuar në VKM Nr.112, datë 23/02/2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", Kreu i V-të (Dispozitë të fundit dhe kalimtare) pika 1, si dhe gërmën ff të nenit 24 të Statutit të UART (Funksionet e Senatit Akademik të UART) kam kënaqësinë t'ju parashtroj propozimin për dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" personalitetit të shkollës së artit skenik, teatrit dhe kinematografisë Prof. Birçe Hasko. Dëshiroj të vë në dukje se Prof. Birçe Hasko këtë vit feston 80 vjetorin e lindjes.

Prof. Birçe Hasko ka një veprimtari të pasur pedagogjike e artistike, e cila përfshin përvojë shumëvjeçare si pedagog, interpretime të shumta në teatër, televizion e kinematografi. Që prej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

shumë vitesh, ai ka shpërfaqur aftësitë e tij të shkëlqyera si pedagog dhe ka interpretuar shumë role në teatër e film me trupa teatrore e regjisorë prestigjiozë, në të cilat ka spikatur me potencialet e mëdha krijuese dhe cilësitë interpretuese.

Prof. Birçe Hasko është diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve (sot Universiteti i Arteve), në Tiranë në vitet 1966-1969. Që në kohën kur ishte student ai ishte një individ i spikatur dhe menjëherë pas diplomimit emërohet pedagog në Institutin e Lartë të Arteve (sot Universiteti i Arteve). Ai prej vitit 1969 e deri në vitin 2004 ka qënë pedagog dhe drejtues në Fakultetin e Artit Skenik, pranë Universitetit të Arteve. Ka drejtuar një nga modulet më të rëndësishme profesionale siç është Mjeshtria e Aktorit.

Po ashtu ai ka drejtuar me cilësi të dallueshme akademike shumë kurse studimi të studentëve të aktrimit, dhe falë punës së jashtëzakonshme të tij, sot kemi një numër të madh prej tyre të cilët kanë shkëlqyer si në teatër ashtu edhe në film, duke kontribuar në rritjen cilësore të artit skenik e atij kinematografik.

Janë të shumtë rolet e interpretuara nga Prof. Birçe Hasko në teatër. Numërohen në rreth 25 figura të tij të interpretuara në teatër ku ka bashkëpunuar me aktorë e regjisorë të shquar. Po ashtu ai ka interpretuar edhe në mbi 30 role në kinematografi e televizion duke reflektuar profesionalizëm në krijimin e figurave të ndryshme e duke u bërë një personazh i dashur për publikun.

Duke besuar se gjithçka shpreha më sipër do të shërbejë si mbështetje për nderimin e kësaj figure të shquar pedagogjike e artistike me dhënien e titullit "Doktor Honoris Causa", gjej rastin për t'ju shprehur të gjithë juve konsideratat më të larta.

Bashkëlidhur po ju dërgoj dy propozimet e kolegëve në FAS edhe curriculum vitae të Prof. Birçe Hasko.

Prof. Petrit MALAJ  
  
DEKAN  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEPARTAMENTI REGJI REGJI FILMI DHE TV

Tiranë, më 21/02/2022

Lënda: Propozim për dhënie titulli "*Doktor Honoris Causa*"

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik  
Prof. Petrit Malaj

## Propozim

Zoti Dekan,

Pedagogu dhe aktori i shquar i teatrit dhe kinemasë shqiptare Prof. Birçe HASKO në 15 Mars 2022 ka 80 vjetorin e lindjes së tij. Ai ka tashmë një kontribut të përveçëm në shkollën e artit skenik, teatrin e filmin shqiptar. Gjithë puna e tij pedagogjike në vite, si dhe krijimtaria në teatër e në film ka zënë një vend të merituar në arkivën e teatrit e kinematografisë shqiptare. Shumë figura të krijuara prej tij janë përcjellë pozitivisht nga kritika vendase dhe e huaj e për këto arritje ka marrë disa çmime të njohura.

Nëpërmjet punës së tij pedagogjike si dhe krijimtarisë së tij ai vlerësohet si një krijues i cili përmbi gjysëm shekulli ka përcjellë dashuri e përkushtim tek të rinjtë për profesionin e aktorit e regjisorit, si dhe nëpërmjet figurave të tij ai ka arritur të shpreh më së miri shpirtin e fuqinë e njeriut shqiptar duke aritur të ndërtojë karaktere të papërsëritshme me stilin dhe gjuhën e pasur artistike të tij.

Krijimtaria dhe figurat e Prof. Birçe Hasko përbëjnë një shembull për studime të mirëfillta kritike në fushën e teatrit e kinemasë.

Ndërkohë shpreh edhe mendimin që ky pedagog e krijues gëzon prej kohësh edhe dimensionin e një intelektualit me integritet të spikatur.

Nisur prej tërë kontributit të këtij personaliteti, ju drejtohem me propozimin që nga Senati i Universitetit të Arteve, të nisë procedurë për t'a shpallur në mënyrë të merituar Prof. Birçe Haskon *Doktor Honoris Causa*.

Prof.Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Shef i Departamentit Regji, Regji Filmi dhe TV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI

Tiranë, më 21/02/2022

Lënda: Propozim për dhënie titulli "*Doktor Honoris Causa*"

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik  
Prof. Petrit Malaj

### Propozim

Zoti Dekan,

Meqënëse është 80 vjetori i lindjs së pedagogut dhe aktorit Prof. Birçe Hasko, mendoj që Universiteti i Arteve ta nderojë me titullin "*Doktor Honoris Causa*."

Puna e tij si pedagog në Universitetin e Arteve prej shumë vitesh, si dhe figurat e interpretuara profesionalisht e mjeshtërisht në teatër e kinematografi janë të spikatura dhe mirënjohura në mbarë botën shqiptare. Shumë prej figurave të krijuara prej tij në film kanë qënë pjesë e shumë festivaleve shqiptare dhe të huaj.

Unë jam besimplotë, që, dekanati i Fakultetit të Artit Skenik, rektorati dhe Senati i Universitetit të Arteve do ta miratojnë këtë inisjativë.

Me respekt,

**Prof. Gazmend GJOKA**

Shef i Departamentit Aktrim dhe Teori  
(Anëtar i Senatit Akademik të Universitetit të  
Arteve)

**Birçe HASKO** (Përmbledhje e jetës dhe aktivitetit pedagogjik e krijues)

Data e lindjes: 15 mars 1942

Vendlindja: Dukat/Vlorë

Vendbanimi: Tiranë

**ARSIMI**

1957-1961 Arsimi i mesëm në Shkollën e Mesme Pedagogjike “Jani Mínga”- Vlorë

1965-1969 Studimet e larta për aktor në Institutin e Lartë të Arteve -Tiranë

**PËRVOJA NË PUNË**

1961-1964 Mësues në shkollën fillore në Amanikaj dhe Memaliaj, Telepelë.

1964-1965 Drejtor i shkollës “Loni Mone”, Poro, Vlorë.2

1969-2012 Pedagog i lëndës “Mjeshtri aktori” në Institutin e Lartë të Arteve (Akademia e Arteve)

1989-1992 Dekan i Fakultetit Skenik- Instituti i Lartë i Arteve

**TITUJ AKADEMIKË**

1995 Ka marrë titullin “Profesor”

**KRIJIMTARIA ARTISTIKE**

**Aktiviteti artistik në teatër (ndër më kryesoret)**

- 1) Shumë zhurmë për asgjë (Don Jani)
- 2) Fillim pranvere (Malka)
- 3) Mësimi nga historia (Çeliku)
- 4) Ishulli i çmendur (Tregtari)
- 5) Shtëpia më dy porta –(1984) (Abaz Kola)
- 6) Familja e peshkatarit- (1984) (Shazoja)
- 7) Shi në plazh- (1985) (Milo Tafani)
- 8) Tiranozauri- (1994) (Kalebi)
- 9) Mysafiri i mallkuar- (1998) (Ministri)
- 10) I pari- (2009) (Flemingu)

### Aktiviteti artistik në kinematografi

- 1) Liqeni im - (2018) Gjyshi
- 2) Sfida - (2018) Pensionisti
- 3) Contromano - (2015) Ish- sigurimsi
- 4) Kronikë provinciale - (2009) Taqo
- 5) I dashur armik - (2004) Çifuti
- 6) Vals - (2002), Komandanti
- 7) Pleqëri të mbarë- (2001), Plaku i varfër
- 8) Tirana, viti zero - (2001) Babai
- 9) Parullat - (2001) Sabafi
- 10) Nata - (1998) Shëëti
- 11) Përgjatë lumit- (1995) Oficeri i policisë
- 12) Inxhinieri i minierës- (1990) Kasua
- 13) Fletë të bardha - (1990) (Film televiziv) Xhafa
- 14) Vetmi – (1990), Teki Maliqi
- 15) Vitet e pritjes (1990) - Xha Rufeti
- 16) Kthimi i ushtrisë së vdekur - (1989) Fshatari
- 17) Historiani dhe kameleonët - (1989) Toger Muharremi
- 18) Shkëlqimi i përkohshëm - (1988) Babai
- 19) Përrallë nga e kaluara - (1987) Plaku i sertë
- 20) Zëvendësi i grave - (1987) Shef Nesimi
- 21) Tre ditë nga një jetë - (1986) Kalo Malushi
- 22) Dhe vjen një ditë - (1986) Dajë Alushi
- 23) Të shoh në sy (Film TV) - (1985) Andrea
- 24) Gurët e shtëpisë sime - (1985) Mësuesi
- 25) Koha nuk pret – (1984) (Film televiziv) Partizani
- 26) Kush vdes në këmbë - (1984) Gjyqtar Jusufi
- 27) Dita e parë e emërimit - (1981) Shoferi i zv. Ministrit
- 28) Në kufi të dy legjendave - (1981) Xhelua
- 29) Skëterrë 43 - (1980) Syrjai
- 30) Njeriu me top - (1979) Tosun Baçi
- 31) Liri a vdekje (film) - (1979) Sotiri
- 32) Radiostacioni (film) - (1979) Mete Aliu
- 33) Koncert në vitin 1936 - (1978) Tellalli
- 34) Shtigje lufte - (1974) Dulla



35) Malet me blerim mbuluar (1971) Osmani

36) Kur zbardhi një ditë - (1971) Sulo Ballisti

**Cmime, urdhra dhe tituj:**

- Titulli “**Artist i Merituar**” (viti 1989)
- Urdhri “**Mjeshtër i Madh**” akorduar nga Presidenti i Republikës (viti 2002)
- Titulli “Naim Frashëri”, Klasi II (1976)
- Medaljoni i Festivalit të 8-të të filmit shqiptar për rolin e Dajë Alushit në filmin “Dhe vjen një ditë” (viti 1987)
- Medaljoni i Festivalit të 9-të të filmit shqiptar për rolin e Shef Nesimit në filmin “Zëvendësi i grave” (viti 1988)
- Titulli “Qytetar Nderi” i qytetit të Orikut (viti 2007)
- Diploma “Personalitet i shquar i Labërisë” dhënë nga Shoqata Kulturore-Atdhetare “Labëria” (viti 2014)